



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ENERGIJË  
DHE INDUSTRIJË

DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 36.34/

Tirane, date 20/12/2016

**Drejtuar:** ZOTIT ROBERT JAMES NASO  
SHOQERIA "JAB RESOURCES" SHPK  
RRUGA "ILO MITKE QAFEZEZI" VILA 12

TIRANE

**Për njoftim:** Z. VIKTOR DODA, DREJTOR I PERGJITHSHEM  
SHERBIMI GJEOLGJIK SHQIPTAR  
ISH INSTITUTI GJEOGRAFIK I USHTRISE  
RRUGA "MYSLYM KETA"

TIRANE

**Lënda:** Njoftim mbi fillimin e procedurave te revokimit te lejes nr. 1640 date 20.06.2013

**I nderuar zoti Naso,**

Shoqëria "Jab Resources" sh.p.k është zotëruese e lejes minerare te kërkim - zbulimit nr.1640 date 20.06.2013, për mineral ari, Komunat Ungrej dhe Kaçinar, te Qarkut Lezhe.

Nga struktura përgjegjëse Shërbimi Gjeologjik Shqiptar me shkresën nr. 712 date 29.04.2015, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë me nr. 2634 date 03.03.2015 është propozuar revokimi i lejes nr.1640 date 20.06.2013, sepse nuk ishin kryer pagesat e garancive financiare te programit minimal te punës dhe rehabilitimit te mjedisit, për vitin e dyte, ne përputhje me pikën 1 e pikën 2, te nenit 31 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Ne kontrollin qe u be ne zbatim te Urdhrin e Ministrit te MEI Nr. 115, date 25.03.2016 "Për verifikimin e realizimit te detyrimeve për lejet minerare te kërkim zbulimit nr.1640 date 20.06.2013 objekti Kaçinar Mirdite dhe nr.1708 date 23.05.2014 objekti Perlat - Shebe. – Tuturinq, Mirdite nga subjekti "Jab Resources" shpk dhe rakordimin e te dhënave te subjektit me ato te Shërbimit Gjeologjik Shqiptar" nga grupi i punës i ngritur për këtë qellim rezultoi se qëndronin te njëjtat probleme, për lejen ne fjale

Me shkresën tuaj nr. 2015/00410, datë 20.05.2015 të dorëzuar në Sh.Gj.Sh, përpara se te mbaroj afati dy vjeçar, keni kërkuar heqjen dore nga leja, por ne zbatim te ligjit duhet te dorëzonit raportin përfundimtar dhe te shlyenit te gjitha detyrimet e garancisë se investimeve për vitin e dyte.

Leja juaj ka mbaruar afatin e vlefshmërisë dy vjeçare me date 20.06.2015, pasi nuk keni kërkuar mbajtjen e gjithë zonës ose një pjese te saj edhe për një vit tjetër, ne zbatim te germës "a" te pikës

nr.4 te nenit 13 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar

Propozimi i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar i bere ne mënyre te përsëritur, për revokim te lejes nr.1640 date 20.06.2013 është i mbështetur ne ligjin nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin minerar ne Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, pasi ju keni shkelur germën "ç" te pikës 1 te nenit 47 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, qe është shkelje ligjore për te cilën një leje minerare revokohet.

Sa me sipër ne zbatim te nenit 48 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin minerar ne Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar, **ju njoftojmë se ka filluar procedura e revokimit te lejes nr.1640 date 20.06.2013, për mineral ari, Komunat Ungrej dhe Kaçinar, te Qarkut Lezhe.**

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do merret vendimi për revokimin e lejes minerare nr.1640 date 20.06.2013.

Ne zbatim te pikës nr.7 te nenit 13 dhe nenit 49 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar, duhet te rehabilitoni zonën e lejes se kërkim - zbulimit ne te cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

**MINISTRI**  
**DAMIAN GJIKNURI**

